



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës  
Press Council of Kosovo  
Savet Štampe Kosova

**25 shtator 2017, Prishtinë,  
Ref:10.08.2017\565-2017**

**Vendim i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj  
ankesës së Frashër Osekut kundër portalit të televizionit  
Rrokum, portaleve Lajmi.net, dhe Gazeta Express**

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në mbledhjen e  
tij të rregullt të mbajtur më 19 shtator 2017, shqyrtoi  
ankesën e Frashër Osekut kundër portalit të Rrokum TV,  
portaleve Lajmi.net, dhe Gazeta Express lidhur me  
artikullin "Oseku i Vetëvendosjes e përdhosi flamurin e  
Kosovës", botuar më 6 gusht 2017, dhe mori këtë

V E N D I M

- Ankesa nuk miratohet

## A R S Y E T I M I

Ankuesi thotë se asnjëherë nuk ka qenë dhe as sot nuk është anëtar i VV-së. Ai ankohet edhe pse këto media kanë botuar disa foto të tij nga Facebook-u me disa personalitete udhëheqëse të VV-së.

KMShK ka shqyrtuar vetëm pjesën se a është apo jo Frashër Oseku anëtar apo simpatizues, por jo edhe çështjet tjera në artikull pasi për to nuk kërkohet në ankesë.

KMShK ka shqyrtuar fotot dhe thirrjet publike të Frashër Osekut drejtuar simpatizantëve të VV-së gjatë vizitës së Visar Imerit dhe Albin Kurtit më 8, 9, dhe 10 prill 2017, në Suedi. Nga kjo del se ai megjithatë ka pasur raporte më të përafërta me VV-në se që deklaroi. Përkatësia partiake është çështje personale, por në rastin konkret kur ai mohon këtë përkatësi, ndërsa faktet flasin ndryshe, Këshilli ka qenë i obliguar që të marrë qëndrime lidhur me këtë çështje.

Andaj, kjo ankesë nuk u miratua ku bordi i KMShK-së nuk gjeti shkelje të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës në Kreun II (Raportimi i së Vërtetës) dhe as në Kreun VII (Privatësia).

Bazuar në atë që u tha më lartë, KMShK vendosi si në dispozitiv të këtij opinioni.

**Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës**